



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe të nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2019 merr këtë

V E N D I M

PËR BARTJEN E BUXHETIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2018 NË VITIN 2019

I.

MIRATOHET Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2018 në vitin 2019.

II.

Shuma e mjeteve të bartura, si në pikën I të këtij vendimi, është **23,342,809.24 €**.

III.

Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, destinohet si në vijim:

1. *Subvencione dhe transfere*, shuma prej **6,811,462.49 €**;
2. *Investimet kapitale*, shuma prej **16,081,346.75 €**;
3. *Shpenzime komunale*, shuma prej **450,000.00 €**;

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore.

V.

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjnë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-401/01-0073815/19, më 29.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



A r s y e t i m

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi dhe Ligjin mbi buxhetin, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve, si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Nga viti 2018 në vitin 2019, barten mjetet në shumë prej **23,342,809.24 €**.

Ndryshimet dhe bartja e mjeteve sipas fushave nga viti 2018 në vitin 2019, është orientuar në këto kategori ekonomike:

- **Shpenzimet komunale** – mjete në shumë prej **450,000.00 €**,

Shuma prej 450,000.00 €, orientohet në programin e Arsimit dhe shkencës, nënprogrami i Administratës për pagesën e obligimeve ndaj komunaleve të bartura nga viti 2018;

- **Subvencione dhe transfere** – mjete në shumë prej **6,811,462.49 €**,

Shuma prej 187,998.49 €, orientohet te programi Administrata dhe personeli, nënprogrami Administrata.

Shuma prej 250,000.00€, orientohet te programi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural, nënprogrami Bujqësia.

Te programi i Kultura, Rinia dhe Sportet, nënprogrami Sporti dhe rekreacioni, orientohen 100,000.00 €,

Shuma prej 6,273,464.00 €, orientohen te programi Administrata dhe personeli, nënprogrami Administrata:

Për borxhet e NPL “Pallati i Rinise” për funksionalizimin e saj, në vlerë prej 3,757,619.00 €, si dhe

Këstet për IMN “Kosova” për pagesën e 20% për ish-punëtorët e ndërmarrjes, në vlerë prej 2,515,845.00 €;

- **Investime kapitale** - mjete në shumë prej **16,081,346.75 €**, të mbetura nga viti 2018. Kjo vlerë paraqet projekte të kontraktuara në vitin 2018 dhe më herët, të cilat barten në vitin 2019. Disa projekte nga buxheti i vitit 2018 nuk janë realizuar, prandaj mjetet e planifikuara për këto projekte do të shpërndahen në projektet ekzistuese.

Detajet për këto projekte janë të paraqitura në tabelat përcjellëse.